


ZYRA E PROKURIMIT

Nr 078/2021

Nr. Protokolli: 113/2021

Për:	GOE Limit L&B sh.p.k.; Multi Business Group sh.p.k., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	27.07.2021



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 26.07.2021 , të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **GOE Limit L&B sh.p.k.; Multi Business Group sh.p.k., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i zonave infrastrukturore të mençura SMART në Komunën e Suharekes- furnizim dhe montim** me Nr. të Prokurimi: **624-21-3815-1-1-1& 624-021-091-111** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 26.07.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik:: **GOE Limit L&B sh.p.k.; Multi Business Group sh.p.k., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i zonave infrastrukturore të mençura SMART në Komunën e Suharekes- furnizim dhe montim** kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të 21.07.2021 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 21.07.2021 .
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **26.07.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Ndërtimi i zonave infrastrukturore te mençura SMART ne Komunen e Suharekes- furnizim dhe montim** me Nr. të Prokurimi: **624-21-3815-1-1-1& 624-021-091-111** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, **21.07.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojnë, ngase ju ne oferten tuaj **sigurimi i tenderit nuk eshte per 120 dite siq eshte kerkuar ne FTD por eshte 119 dite, mungon marrveshja e koncersiumit me operatorin mbeshtetes, OE nuk ka shifer te aktiviteti ne informatat e biznesit per te ushtruar kete aktivitet biznesore. Nuk ka autorizim nga prodhuesi SIGNATEKMA per ngjyra dhe tabela si dhe autorizimin per foli adezive. Dokumentacioni i radareve mungon katalogu i produkteve.**

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit

Afrim BYTYOI

